

## **Financuesit e LDK-së që janë edhe biznesmenë**

Në fushatën parazgjedhore të viti 2010, për dallim të asaj të vitit 2009, Lidhja Demokratike e Kosovës vendosi të publikojë pak emra të financuesve të saj. Preportr, në raportin e auditimit të financave të partive të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ka gjetur se një pjesë e tyre janë biznesmenë.

Preportr ka gjetur se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë marrë hise nga tenderët publik, por ka edhe nga ata që janë favorizuar për më shumë se një dekadë, siç është rasti i "AMM-së".

Donatorët e LDK-së që dhanë fonde për fushatën e kësaj partie si persona fizik, por që del të jenë edhe biznesmenë, janë :

**1. Latif Voci** nga Suhareka , që për LDK-në dha donacion 500 euro, ka në pronësi kompaninë **"Voci"** dhe **"Estrada"**, por që nuk është gjetur të jenë përfituese të fondeve publike.

**2. Xhemajl Hoxha** nga Suhareka, që për LDK-në dha donacion 370 euro, del të jetë aksionar tep ërfaqësia e „Siteep" Sh.p.k. por që nuk është gjetur të jetë përfituese e fondeve publike.

**3. Nexhmedin Fetoshi** që për LDK-në dha 500 euro donacion, ka në pronësi të plotë ose aksione në shtatë biznese: **"Fat Group"** **"Euro-4"** , **"Eurobeton"** , **"Euro-Fat 5"** , **"Tulltorja 6"** **"Fetoshi 7"** dhe **"Fat Oil"**.

Nga Komuna e Prizrenit në vitin 2006, sa këtë komunë po e udhëhiqte Eqrem Kryeziu, ndërmarrja INM **Tulltorja** nga Landovica, u lejua që të shfrytëzojë dheun (argjilën) në ngastrën kadastrore nr. 1292/1 dhe 1293 ZK Piranë e që është pasuri shoqërore e Komunës së Prizrenit. Çmimi për 1m<sup>3</sup> për shfrytëzimin e dheut është 1.02 shumë kjo e cila duhej të paguhej në emër të Komunës dhe që ishte e caktuar në Udhëzimin Komunal 1/2002.

**4. Nazmi Muçaj** nga Prizreni, që për LDK-në dha 1 mijë euro, del të jetë pronar **N.T.H. "BUJARI"**, por që nuk del të jetë përfitues e fondeve publike.

**5. Vahid Karavidaj** nga Prizreni që për LDK-në dha 1 mijë euro del të jetë pronar i kompanisë **N.T.SH. "VECTOR"**. Kjo kompani në vitin 2011 ka marrë nga Policia e Kosovës një tender prej 890 mijë eurosh.

**6. Mustafë Krasniqi** nga Prishtina, që për LDK-në dha mbi 700 euro donacion ka në pronësi biznesin **Ndërmarrja Private Ndertimore „GRANITI"**, pro që nuk ka përfituar nga fondet publike

**7. Abdullah Softolli** nga Podujeva, që për LDK-në dha donacion 1500 euro ka në pronësi kompaninë **D.P.Z. " DULI "**, pro që nuk del se ka përfituar nga fondet publike.

**8. Metë Ademaj** nga Peja që për LDK-na dha donacion 500 euro del të jetë pronar i **NDËRMARRJA PRODHUESE TREGTARE " MOLIKA "**, që nuk del të ketë përfituar nga fondet publike.

**9. Nexhat Draga** nga Peja që për LDK-në dha 400 euro ka në pronësi kompaninë **N.T. " NEDEX "**, që nuk del të ketë përfituar nga fondet publike.

**10. Xhavit Çollaku** nga Peja që për LDK-në dha 400 euro ka në pronësi kompanitë: **ANSIIA -AGJENCIA NDËRMJETSUESE E SIGURIMEVE "**, **"Unikat " Sh.p.k."** dhe **Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale –" URA VISION"**.

Me kompaninë " Unikat " Sh.p.k. është kontraktuar nga Policia e Kosovës për furnizim me jakne, në vlerë prej mbi 4 mijë eurosh. Në vitin 2010 është pajisur me licencë për të operuar si institucion arsimor parauniversitar me kompaninë e tij Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale –" URA VISION".

**11. Sylejman Dervishaj** nga Peja që për LDK-në dha 300 euro ka në pronësi biznesin " ARALBI & 7D " SH.P.K., me të cilën nuk del të ketë marrë hise nga fondet publike.

**12. Kenan Krasniqi** nga Peja që për LDK-në dha 300 euro del të jetë pronar i **N.SH.N."ADE"** me të cilën në vitin 2011 nga Komuna e Pejës ka marrë tenderin 'Revidimi i hartimit dhe dizajnit të Stadionit futbollistik –Pejë", prej 8800 eurosh

**13. Faruk Zekaj** nga Peja që për LDK-në dha 200 euro del të jetë pronar i kompanisë **N.T.SH. "ZEKAJ - TOURS"** me të cilën nga KEK-u në vitin 2011 është kontraktuar për një punë për bartjen e punëtorëve nga Peja.

**14. Hamëz Shala** nga Malisheva që për LDK-në dha mbi 1 mijë euro ka në pronësi kompaninë **N.SH. " TERMOKLIMA "**, me të cilën në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e Malishevës me një tender prej 7 mijë eurosh

**15. Naser Sopjani** nga Lipjani që për LDK-në dha 800 euro është pronar **NDËRMARRJA TREGTARE PRIVATE SHËRBYESE "ARAGONIT "**, që nuk del të jetë përfitues e fondeve publike.

**16. Aziz Desku** nga Klina që për LDK-në dha mbi 500 euro donacion del të jetë person i autorizuar në kompaninë **N.P.SH. " LINDA "** ku pronar është **Ahmet Krasniqi**, me të cilën nuk del të ketë përfituar nga fondet publike.

**17. Muzli Zubaku** nga Kamenica që për LDK-në dha 400 euro del të jetë pronar në kompanitë: **N.T.P.,,Topanica-M"** dhe **N.N.T. " Global Project"**. Të dyja këto kompani marrin tenderë publik në të Komunës së Kamenicës.

**18. Rabit Halili** nga Kamenica që për LDK-në dha 200 euro ka në pronësi biznesin **N.N. " LEDI - SH "**, që nuk del të jetë përfituese e tenderëve publik.

**19. Ilaz Zharku** nga Kaçaniku, që është edhe vëllai i deputetit të LDK-së, dhe përgjegjësit për financa në këtë parti, **Lurfi Zharku**, ka dhënë për këtë parti një donacion prej 750 eurosh. Në regjistrin e bizneseve ky person ka aksione në 4 kompani: **"Cons O.K."**, **"Kaçaniku - Commerce " Sh.p.k."**, **"Kosovo Cement & Concrete Company " L.L.C. dhe " INEX petrol " Sh.p.k.**

Kur plasi "skandali me cement" në vitin 2012, i shkaktuar nga një vendim i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari, ishte vëllai i Ilaz Zharkut, deputeti i LDK-së, Lutfiu që në Kuvendin e Kosovës po i mbronte interesat e bizneseve në të cilat aksione ka ai dhe vëllai i tij.

Kështu, Lutfi Zharku, që MTI-në e kishte drejtuar para Kusarit, në mbledhjen të këtij organi më 4 korrik 2012, tha se vendimi, ndonëse ka bazë ligjore, shkel procedurat që parashihen në implementimin e vendimeve. Duke kundërshtuar të dhënat e paraqitura nga ministrja Lila, ai ngriti edhe dyshimin që ka të bëjë me importin e lëndës së parë nga "SharrCem", për ç'gjë kjo kompani aktualisht është në kontest doganor me autoritetet përkatëse të Doganave të Kosovës.

Por, Zharku duket që me Mimoza Kusarin nuk e ka vetëm inatin e karriges. Ai ka kohë që është i lidhur me industrinë e çimentos. Ky ish-ministër, bashkë me vëllanë e tij, patën krijuar kompani të përbashkët me kompaninë që kishte menaxhuar për dhjetë vjet çimentoren "SharrCem". Zharku kishte bindur zviceranët që të hapnin kompani të përbashkët që merret me biznesin e çimentos gjatë kohës sa ishte ministër i Tregtisë dhe i Industrisë, kur kishte mandatin për të sjellë kompani të huaja për të investuar në Kosovë, kishte shkruar Koha Ditore një vit më parë.

Sipas KD, Zharku gjatë mandatit të tij ministror i kishte bindur zviceranët që të krijonin një kompani private të përbashkët, "Holcim Group", një kompani e themeluar në Zvicër në vitin 1912 e që merret me biznesin e çimentos. Kur u publikua ky fakt, Zharku kishte këmbëngulur që nuk ka kurrëgjë të keqe t'i thuash dikujt: 'Hajde investo në Kosovë' e të bashkëpunosh me të sa je ministër. "Kush ka pare hyn në biznes dhe unë kam futur pare në këtë biznes", pati deklaruar atëherë Zharku.

E në regjistrin e bizneseve, në vitin 2011, figuron se kjo kompani pati pronarë "Holcim Auslandsbeteiligungs GMBH" dhe Ilaz Zharkun, vëllain e Lutfi Zharkut. Madje, person i autorizuar ishte dora vetë, Lutfi Zharku. Në këtë kompani vëllai i Lutfi Zharkut, sipas deklarimeve të tij ishte i dyti për nga pronësia e aksioneve, kurse vetë Lutfiu mbante pozitën e drejtorit të përgjithshëm.

Kompania ishte konstituuar më 25 korrik të viti 2011, por tash nuk gjendet më në regjistrin e bizneseve. Megjithatë, Lutfi Zharku nuk i është ndarë industrisë së çimentos. Sipas deklarimit të pasurisë në vitin 2011, si deputet i Kuvendit të Kosovës, Zharku pranon se punon për kompaninë "Kosovo Cement & Concrete Company", që merret edhe me prodhimin e betonit të gatshëm për ndërtim.

Çuditërisht, edhe pse "Holcim Group" më duket të mos jetë aktive, në kompaninë "Kosovo Cement & Concrete Company" pronari është i njëjtë. Sikurse te "Holcim Group", edhe në këtë fundit pronar është "Holcim Auslandsbeteiligungs GMBH" dhe kompania për herë të fundit është konstituuar më 07-04-2012. Në kompani, te certifikata e biznesit, më nuk ka persona me mbiemrin Zharku, pos Lutfi Zharkut, i cili pranon vetë se punon aty. Në këtë kompani si persona kontaktues janë shkruar Fitore Mekaj, Suzana Vujičić dhe Šaludovac Paracin.

Duket që Lutfi Zharku është "mbushur mend". Derisa një vit më parë figuronte vetë si person kontaktues, kurse të vëllanë e kishte aksionar me një kompani çimentoje, nuk kaloi shumë kohë dhe ai

pranoi që veç punon për një kompani në këtë industri. Por, në deklarinimin e tij të fundit të pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsion, 2012-ën, me letra Lutfi Zharku ka shkëputur çdo lidhje me industrinë e çimentos. Ai në formularin e dorëzuar më 30.03.2012, nuk ka as aksione e as që punon në ndonjë kompani që ka lidhje me këtë industri.

**20. Fetah Bakija** nga Gjakova që për LDK-në dha 500 euro del të jetë pronar i **N.T.P., FEBA**, që nuk del të ketë marrë nga tenderët publik.

**21. Malush Tullumi** nga Gjakova që për LDK-në ka dhënë 390 euro del të jetë aksionar në kompanitë: **N.T.P. "Lerra Design"** dhe **"E.E.K. SH.P.K.**, në të fundit aksionar janë edhe **Agim Jaka, Sutki Nikoliqi, Skender Nikoliqi, por** me këto kompani nuk del që të jenë përfituar tenderë publikë.

**22. Xhafer Tahiri** nga Prishtina që për LDK-në dha 1 mijë euro donacion del të jetë aksionar në biznesin **"KOSOVO CONSULTANTS GROUP SH.P.K.**, ku aksionar janë edhe **Igballe Perçuku dhe Islam Hasani.** Nuk del që kjo kompani të ketë marrë deri tash tenderë publikë.

**23. Bahri Thaqi** nga Prishtina që për LDK-në dha donacion prej 1 mijë eurosh, del të jetë pronar i biznesit **"OP,, SHPETIMI "**. që nuk del se ka marrë hise nga tenderët publikë.

--Për LDK-në një donacion prej 950 eurosh e ka dhënë kompania **"DIGGIËORX " SH.P.K.**, pronë e Halil Hetemit dhe **Bunjamin Avdijati.** Aksionari i madh i kësaj kompanie, Halil Hetemi është edhe drejtor i gazetës **"Zëri"**. Hetemi ka në pronësi edhe kompaninë **"Intermedia" Sh.P.K.**

-Për LDK-në një donacion prej 950 eurosh e ka dhënë kompania **"AMM"**, pronë e **Gezim Salihut, Ahmed Kurtollit.**

AMM-ja është një kompani e favorizuar nga Komuna e Prishtinës, pasi që ajo që nga viti 200 mban monopolin e vendosjes së reklamave në kryeqytet, derisa edhe kontrata mbi të cilën ajo punon mbahet si top-sekret nga Komuna e Prishtinës.

Po në vitin 2006, ZAP gjeti parregullsi në kontratën me kompaninë AMM, pronë e Gezim Salihu, Ahmed Kurtolli. Kjo kompani më vonë do të ishte financuese e LDK-s, partia që tradicionalisht udhëheq me qeverinë lokale në Prishtinë. **Preportr** ka publikuar deri më tash dy hulumtime (**"Monopoli komunal në reklama" dhe "AMM – Absolut Mustafa Monopol"**) për këtë kontratë, por ka hasur në bllokim total nga ana e Komunës së Prishtinës, kur bëhet fjalë për qasje në dokumente publike-kontratën e "AMM"-së me Komunën e Prishtinës.

Auditorët që në vitin 2006 gjetën se çmimet e kësaj kontrate, të lidhur mes komunës në fjalë dhe "AMM-së" janë për 50% më të ulëta se tarifata komunale ekzistuese. Ndër shkeljet e tjera që ishin gjetur në këtë kontratë, ishte se në panotë e ekspozuara vërejtëm se reklamohet duhani dhe alkooli edhe përkundër asaj se në rregulloren komunale për taksë e tarifa është e ndaluar të reklamohen këta artikuj, se ishin lëshuar dy akt-vendime të kundërligjshme mbi këtë kontratë, njëra për vendosjen e posterit të Bill Klintonit ndërsa tjetra për lirim për promovimin e albumit muzikor. "Për asnjërën nuk janë përdorë procedura të prokurimit. Mosrespektim i kushteve të kontratës për artikujt që dëmtojnë shëndetin. Mungesë e transparencës dhe devijim nga rregullat për taksë dhe tarifa", ishin disa nga gjetjet e ZAP për

kontratën, deri tash sekrete, në mes të Komunës së Prishtinës dhe financuesve të LDK-së, Kurtolli e Salihu.